



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 169 prot.

Kamëz, më 25.11 .2022

V E N D I M
Nr. 140 .Datë 25.11 2022
M B I

“MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË NË TREGUN E LIRË”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.11.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.124 Datë 22.11.2022 në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr.301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 datë 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKM nr. 459 datë 03.09.2019 “Rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe ministrisë përgjegjëse për strehim”; Udhëzim nr.31 dt.18.11.2019 “Për procedurat standartet e aplikimit dhe kriteret për përfitim të fondeve nga buxheti shtetit për programet e strehimit”; Vendimit nr.65 datë 25.06.2020, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”; Vendimit nr.4 datë 17.01.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”; VKB nr. 132 datë 22.12.2021 “Për miratimin e detajmit të buxhetit të vitit 2022; Vendimit nr.152 datë 18.12.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë për Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”, Vendimit nr. 160 dt.23.12.2020 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2021,2022,2023”, Shkresës me nr. prot.1237 dt.24.01.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Relacionit Komisionit Strehimit me nr.9629 Prot datë 20.10.2022; Procesverbalit Komisionit Strehimit me nr. Prot 9629/1 datë 20.10.2022; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së përfituesve dhe vlerën e subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2022, sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë nga muaji Nëntor 2022 deri në Dhjetor 2022.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 në shumën prej **18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, do të përballohen 100% nga buxheti i Bashkisë Kamëz.**
4. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.

Bashkëngjitur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

